



BURSA PËR STUDIME UNIVERSITARE NË SLOVAKI VITI AKADEMIK 2023-2024

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me Sllovakinë në fushën e arsimit, qeveria sllovaqe ofron bursa studimi universitare në nivelin Bachelor/Master për shtetasit shqiptarë, të cilët dëshirojnë të studiojnë në institucionet shtetërore të arsimit të lartë të Republikës së Sllovakisë për vitin akademik 2023-2024 sipas fushave të studimit në vijim:

1. Trajnimi i mësuesve dhe shkencat e edukimit;¹
2. Ekonomi dhe menaxhim;
3. Ekologji dhe shkenca mjedisore;
4. Bioteknologji;
5. Agrikulturë dhe peizazh;
6. Shkenca dhe teknologjia e drurit;
7. Pyjëtari;
8. Arkitekturë dhe urbanistikë;
9. Inxhinieri mekanike;
10. Inxhinieri civile;
11. Kibernetikë;
12. Inxhinieri elektrike dhe elektronike;
13. Inxhinieri kimike dhe teknologji;
14. Shkenca ushqimore;
15. Transport;
16. Nxjerrja dhe përpunimi i burimeve natyrore;
17. Mjekësi e përgjithshme;²
18. Shëndeti publik.

Kandidatët e interesuar për këto bursa studimi universitar (bachelor dhe master) duhet të jenë 18 – 26 vjeç. Bursa ofrohet vetëm për studimin e kryer në gjuhën sllovaqe. Nëse nuk mund të flisni sllovakisht, duhet të kaloni një kurs 10-mujor të gjuhës sllovaqe (ky kurs mbulohet nga bursa). Kandidatët duhet të regjistrohen në faqen zyrtare të web-it <https://www.vladnestipendia.sk/en/> sipas kriterëve të vendosura nga pala sllovaqe, si dhe duhet të dërgojnë **detyrimisht** me postë në Drejtorinë e Integritimit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, dokumentet e mëposhtme **brenda datës 30 maj 2023**:

Për programe studimi Bachelor:

1. Kërkesën për studime, duke specifikuar programin e studimit, në të cilin kandidati dëshiron

¹ Për këtë program studimi mund të aplikohet për studime Bachelor ose Master veçmas, ose Bachelor dhe Master së bashku.

² Për këtë program studimi nuk është e mundur të aplikoni vetëm për studime Bachelor ose vetëm për Master. Mundësia e vetme është të aplikoni për studime Bachelor dhe Master së bashku.

- të studiojë sipas fushave të mësipërme. Në kërkesë të jepet një adresë kontakti e-maili dhe numër telefoni;
2. Vërtetimin e notave për dy vitet e para dhe të semestrit të parë të vitit të tretë të shkollës së mesme. Ky vërtetim duhet të jetë i firmosur nga Drejtoria Rajonale/Zyra Arsimore e rrethit përkatës dhe nga Qendra e Shërbimeve Arsimore në Tiranë. Kërkohet përkthim i vërtetuar i këtij dokumenti në anglisht, sllovakisht, çekisht, frëngjisht ose spanjisht ; ose një certifikatë përfundimi e shkollës ose diplomë universitare. Dokumenti i përfundimit të studimeve mund të bashkëlidhet deri më 31 gusht - vlen vetëm për studentët që nuk kanë përfunduar ende arsimin në momentin e aplikimit për bursë.
 3. Certifikata e lindjes - Nëse një certifikatë lindjeje është në gjuhë tjetër përveç sllovakisht, çekisht, anglisht, frëngjisht ose spanjisht, atëherë kërkohet një përkthim i vërtetuar në një nga këto gjuhë;
 4. Dy letra rekomandimi nga mësuesit e shkollave të mesme;
 5. CV dhe Letër Motivimi- CV e nënshkruar dhe letër motivuese e nënshkruar (shkurtimisht tregoni pse vendosët të studioni në Sllovaki, pse vendosët të studioni specializimin e zgjedhur ose si e shihni të ardhmen tuaj pas diplomimit);
 6. Fotokopjen e faqes së pasaportës me të dhënat e identitetit;
 7. Raportin mjekësor për aftësi studimi;
 8. Një fotografi me përmasa 3,5 cm x 4 cm që tregon fytyrën e plotë të personit, pa syze me lente të errëta, me lartësinë e fytyrës nga sytë deri te mjekra të paktën 13 mm; Rezolucioni minimal prej 350 x 400 piksel kërkohet për imazhet digjitale;
 9. Formulari i aplikimit i nënshkruar - Shtypni PDF-në e formularit të plotësuar të aplikimit, të cilin mund ta gjeni në llogarinë tuaj, seksioni 1. Aplikimi nën emrin "Dokument". Nënshkruani pjesën e fundit të tij të quajtur "Konfirmim" dhe bashkëngjitni skanimin e tij.

Për programe studimi universitare Master:

1. Kërkesën për studime universitare *Master*, duke specifikuar programin e studimit, në të cilin kandidati dëshiron të studiojë. Kërkesa të jetë e nënshkruar nga kandidati dhe të përmbajë adresë e-mail dhe numër kontakti;
2. Fotokopjen e noterizuar të diplomës së shkollës së lartë (Bachelor) dhe listën e notave; Nëse nuk i keni mbaruar ende studimet, mund t'i bashkëngjitni rezultatet (listën e notave) nga viti i fundit deri më 31 gusht;
3. Certifikata e lindjes - Nëse një certifikatë lindjeje është në gjuhë tjetër përveç sllovakisht, çekisht, anglisht, frëngjisht ose spanjisht, atëherë kërkohet një përkthim i vërtetuar në një nga këto gjuhë;
4. CV dhe Letër Motivimi- CV e nënshkruar dhe letër motivuese e nënshkruar (shkurtimisht tregoni pse vendosët të studioni në Sllovaki, pse vendosët të studioni specializimin e zgjedhur ose si e shihni të ardhmen tuaj pas diplomimit);
5. Dy letra rekomandimi nga mësuesit e Universitetit;
6. Raportin mjekësor për aftësi studimi;
7. Fotokopjen e faqes së pasaportës me të dhënat e identitetit;
8. Një fotografi me përmasa 3,5 cm x 4 cm që tregon fytyrën e plotë të personit, pa syze me lente të errëta, me lartësinë e fytyrës nga sytë deri te mjekra të paktën 13 mm; Rezolucioni minimal prej 350 x 400 piksel/ kërkohet për imazhet digjitale;
9. Formulari i aplikimit i nënshkruar - Shtypni PDF-në e formularit të plotësuar të aplikimit, të cilin mund ta gjeni në llogarinë tuaj, seksioni 1. Aplikimet nën emrin "Dokument".

Nënshkruani pjesën e fundit të tij të quajtur "Konfirmim" dhe bashkëngjitni skanimin e tij.

Theksojmë se me postë duhet të dërgohen **detyrimisht kopjet e noterizuara** të dokumentacionit të ngarkuar online me qëllim verifikimin e autenticitetit të tyre, si dhe të përfshihet edhe kopja e printuar e formularit të aplikimit.

Në rast se kandidatët do të aplikojnë vetëm online pa depozituar dokumentacionin fizik në MAS, ose duke depozituar vetëm dokumentacionin në MAS pa procedurën e aplikimit online, do të s'kualifikohen dhe nuk do të jenë pjesë e vlerësimit.

Në përfundim të vlerësimit të dosjeve tuaja në rast kontestimi, jeni të lutur të paraqisni ankesën tuaj me shkrim të firmosur pranë MAS.

Kushtet për përfitimin e bursës, për mënyrën e aplikimit dhe të përgatitjes së dokumentacionit, përshkrimin e detajuar të programeve studimore, si dhe informacione të tjera gjenden në faqen e internetit të Ministrisë së Arsimit të Republikës së Sllovakisë:

<https://www.minedu.sk/scholarships-of-the-government-of-the-slovak-republic>

DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS

Adresa: Rruga e Durrësit Nr. 23, AL 1001, Tiranë
www.arsimi.gov.al